

Qëndrimi i shpeshtë jashtë shtetit i krerëve të Lipjanit, nxit reagime

## Opozita dhe shoqëria civile u kërkojnë pushtetarëve llogari për vizitat jashtë shtetit

KOHJA

ARIAN DURIQI

LIPJAN, 9 SHTATOR – Shoqëria civile e Lipjanit dhe Dega e AAK-së kanë kërkuar llogaridhënie nga krerët komunalë rreth vizitave të tyre të fundit jashtë vendit. Kreu i Lipjanit, Shukri Buja, dhe kryesuesi i KK-së, Lulëzim Rrustemi, së fundi kanë qëndruar në Gjermani.

Xhevat Olluri (AAK), ngre një nevojë të domosdoshme që krerët komunalë të sqarohen para Kuvendit për qëllimin dhe rezultatet në qoftë se ato eventualisht janë arritur gjatë vizitës.

"Ata duhet ta arsyetojnë vizitën, sepse duhet të dihet qëllimi dhe rezultati cili ishte pas vizitës, sepse tekefundit janë shpenzuar mjete të buxhetit komunal për këtë punë", ka thënë Olluri.

Ndërkohë udhëheqës të Lipjanit rreth kësaj vizite janë gjendur edhe nën thjerrën e shoqërisë civile në këtë komunë. Së fundi, Organizata e të Rinjve YAHR, i është drejtuar me letër të hapur kreut të Lipjanit, Buja, për sqarime shtesë rreth vizitës në Gjermani.

"Kërkojmë që kryetari i Komunës, Buja, dhe kryesuesi i KK-së, Rrustemi, ta informojnë opinionin publik të Komunës së Lipjanit lidhur me vizitën zyrtare në shtetet perëndimore me ndonjë raport para Kuvendit Komunal", ka thënë Bekim Krasniqi, udhëheqës i Organizatës së të Rinjve në Lipjan, YAHR.

Kjo kërkesë nga kjo OJQ, Krasniqi thotë të ketë ardhur pasi



që kjo organizatë nuk ka marrë deri tash informacione të mjaftueshme për këtë vizitë. "Edhe pse ne si organizatë joqeveritare kemi kërkuar informata lidhur me qëllimin e kësaj vizite jashtë shtetit nga zyrtarët për informim të ekzekutivit të Komunës së Lipjanit, nuk kemi arritur që të marrim asnjë informatë të plotë me përjashtim të informatës se kryetari gjendet për vizitë zyrtare jashtë shtetit", ka thënë Krasniqi, derisa ka shtuar se kërkesa e tij është e mbështetur në bazë të Rregullores komunale për transparencë, nenet 5.1 dhe 5.2. Lidhur me këtë kërkesë, ndërkohë është përgjigjur Zyra e informacionit publik në Lipjan. Hasan Luma, shef i kësaj zyre, ka thënë se vizita e kreut të Lipjanit,

Buja, dhe kryesuesit Rrustemi, është realizuar në një Panair Nderkombëtar në Munihi të Gjermanisë, ndërsa kjo vizitë, sipas tij, është bërë nëpërmjet Odës Ekonomike Gjermane në bashkëpunim me firmën "Ilat Entsorga".

"Vizita e udhëheqësve të Komunës në Panairin Nderkombëtar të Munihi të pasurive të paluajtshme dhe investimeve ka qenë e mirëseardhur për përfitimim e njohurive për trajtimin e ujërave të zeza, ujit të pijshëm, pastrimin e qytetit dhe rregullimin e parqeve. Ndërsa, sa i përket raportimit në Kuvend që kërkon YAHR, është paraparë që kryetari i Komunës të raportojë një herë në gjashtë muaj para Kuvendit", ka deklaruar Luma.

Pushteti lokal nuk arrin ta ndryshojë aktin më të lart komunal

## Deçani ende me statut komunal të vjetër

KOHJA

ZANA META

DEÇAN, 9 TETOR – Komuna e Deçanit ende ka mbetur pa aprovuar aktin më të lartë – Statutin. Pozita nuk ka arritur që me numrin e votave që ka në Asamblesë Komunale ta ndryshojë këtë dokument.

Opozita ka dalë më e fuqishme me numrin e votave dhe tash e sa muaj zvarritet çështja e aprovimit



gjistralen  
tjetër  
rje  
gesë  
lirë

urave kërkojnë që  
arrë masa për këtë  
lokal janë zotuar  
a zgjidhin



tunës afër këtij tregu. "Me kjo është brengë serioze, herë kemi kërkuar nga që të bëjë zgjidhje për këtë nuk kemi marrë përgjigje, ve po na shkakton probleme, por çështja është se duhet ta zgjidhë këtë problem shpejt", ka bërë thirrje komandant i Stacionit të Prizren. Ndërsa, Hazir zedhënës i Policisë së për rajonin e Prizrenit, ka thënë se ky auto treg ka qenë nga shkaktarët që kanë kolonat e gjata gjatë verës, kur shumë turistë rrytëzuar këtë rrugë për në bregdet. Nga ana tjetër, prisha, shef i Zyrës për në Komunën e Prizrenit, e ditur se kanë informacione të tregut pengohet ai i lirë. Ai ka thënë se për problematikë është duke një komision përkatës. Drejtorja e Shërbimeve ka formuar një grup të dhe ka dalë në terren të gjenden. Dhe tani janë dim e sipër të një propozitshjen e këtij problemi të e me pronarin që menax-tregun", ka deklaruar